

**Dafina (Muhaxhiri) Nela**

## **Trungu im familjar**

Nga detyra e dhënë lidhur me shkrimin e një gjenealogjie familjare, gjegjësisht për të pasqyruar degëzimin e trungut të familjes sime, mora guximin që unë e para të mundohem në formë kronologjike (për aq sa kam dëshmi të dëgjua nga gjyshi im, hallat e babait, xhaxhallarët dhe prindërit e mi), të jap të dhënat e familjes sime të cilat janë:

Mbiemri im i vajzërisë **Muhaxhiri** ndërlidhet me një episod të hidhur të historisë së popullit shqiptar. Pra, prejardhja e të parëve dhe e familjes sime rrjedhë nga rajoni i Toplicës që bënte pjesë në Sanxhakun e Nishit.

Ardhja e saktë e të parëve tanë këtu në Kosovë, daton që nga dimri i vitit 1878 kur u bë shpërngulja më e madhe e popullatës joserbe (pra asaj shqiptare) të asaj kohe nga trojet e veta të këtij nënqielli të Gadishullit të Ballkanit.

E quaj si vit dhe kohë të saktë ardhjen e të parëve tanë këtu në Kosovë, sepse nga gjyshi im i ndjerë z. **Rexhep (Kurti 1919 - 1994) Muhaxheri** e kam dëgjuar disa herë rrëfimin e tij që ia kishte treguar edhe këtij babai i tij (**Beqir Kurti 1878 - 1961**) e që ishte paksa i veçantë, sepse ky kishte lindur në karrocë të qeve me të cilin udhëtonin gjatë atij dëbimi të dhunshëm në dimrin e vitit 1878, dhe se gjatë një pushimi që kishte bërë familja gjatë rrugëtimit, kishin ndezur një zjarr për t'u ngrohë disa nga familjarët, e sidomos lehona e cila sapo e kishte lindur fëmijën (gjyshin e prindit tim - Beqirin). Për tu ngrohur sa më shumë foshnja, e ëma e kishte hapur atë pjesë të mbulojës së tij, dhe fare aksidentalisht, nga zjarri i ndezur kishte pëlcitur një gacë e cila i kishte rënë në gjoks. Ajo vragë e vogël e foshnjërisë, i ishte rritur vazhdimisht dhe për të ishte si një relik të cilin e pati si kujtim nga dita e parë e lindjes.

Të dhënat e shpjegimit tim për trungun familjar, kam arritur që t'i sigurojë për pesë (5) breza të mëparshëm duke filluar nga **Haliti** (mbiemrin e atëhershëm nuk ia di) kishte pasur pesë djemë, pra:

- I. **Haliti** \_\_\_\_\_ (duhet bërë përpjekje për gjetje të shënimeve), la pas veti djemtë:
  1. Kurtin – i cili u vendos në Kosovë (Gjakovë);
  2. Mehmetalun – i cili shkoi në Turqi; ( mjek në Turqi)
  3. Zeqirjanë – edhe ky i shpërngulur në Turqi;
  4. Ahmetin – i vendosur në Mitrovicë;
  5. Rizanë – i vendosur në Prishtinë.

I pari (Kurti) ishte babai i Beqirit (gjyshit të babait tim) i cili nga familja e ngushtë la:

## **II. Kurti:**

1. Beqir Kurtin 1878 – 1961 i martuar me Xhevahiren e familjes Gola 1905 – 1960);
2. Arif Kurtin 1900 – 1925 (i plagosur nga hasmëria në moshë të re 25 vjeçare dhe pas dy javësh, i arratisur nga familja kishte vdekur dhe varrosur nga i vëllai Beqiri në Parruc të Shkodrës);
3. Sanije apo Sevdije Kurtin 1884 - ? (e grabitur dhe martuar në Shqipëri);
4. Shahe Kurtin 1888 - ? (e martuar te familja Karrica);

Nga i pari i kësaj familje, pra nga Beqir Kurti 1878 – 1961 kemi këta trashëgimtarë:

### III. Beqiri:

1. Rexhep Kurti – **Muhaxhiri**<sup>1</sup> lindur më 20.05.1919 dhe vdekur më 28. 11.1994 i martuar me Xhejlanen, të familjes Xharra lindur në Prizren dhe vdekur në Gjakovë në 2007;
2. Mehmetali Kurti – Muhaxhiri 1923 – 2002 i martuar me Zymryten të familjes Dibra;
3. Emine Kurti – Muhaxhiri 1928 – 1998
4. Safete Kurti – Muhaxhiri 1931
5. Halime Kurti – Muhaxhiri 1937 – 2002

Është e rëndësishme të përmendet se mbiemrin **Muhaxhiri**, familja e ka marrë pas Luftës së II Botërore kur është bërë regjistrimi i dytë i popullsisë. Por, për shumicën e njerëzve, identifikimi i pjesëtarëve të kësaj familje me këtë mbiemër, nuk ka treguar identifikim të saktë, sepse shumica prej tyre, të parët tanë më tepër i kanë njohur si familja **Kurti**, apo **Beqkurti**.

Për të sqaruar më kuptimshëm për gjeneratat e reja epitelin e mbetur të emrit **muhaxhir** të cilin e bartin shumë familje shqiptare këtu në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Shqipëri, Turqi dhe shumë vende tjera të botës, duhet shkëputur disa episode të hidhura nga historia jonë e rëndë e cila shekuj me radhë na ka përcjellë brez pas brezi si kjo kur “shqiptarët janë shpërngulur në kushte shumë të vështira në dimër të viteve 1877 – 1878. Masivisht kanë lënë shtëpitë dhe gjënë e gjallë, me fëmijë në dorë, këmbë, pa ushqim, zbathur e zhveshur. Pasardhësit e parë të **muhaxhirëve** gjithnjë e kanë në kujtim shpërnguljen e tyre dhe pohojnë se me rastin e ikjes, disa kanë harruar edhe fëmijët e vegjël në djep. Shpërngulja ishte e tmerrshme dhe e vështirë. Shumë prej tyre janë ngrirë nga të ftohtit dhe kanë vdekur gjatë rrugës. Princi i Serbisë, Milan Obrenoviq urdhëroi ushtarët dhe paramilitarët çetnikë: “Merita më të mëdha ndaj shtetit dhe kombit serb do t’i ketë ai, i cili do të arrijë të zhdukë e të shpërngulë më shumë shqiptarë”<sup>2</sup>. Pra, në kushte të një dimri me borë që nuk mbahet mend, kjo ushtri mizore e kriminale, nxori nga shtëpitë e tyre rreth 300.000 shqiptarë të Toplicës, Kosaonicës, Pustarekës etj. që banonin në

<sup>1</sup> Muhaxhir – i; emër arab (mërgimtar, emigrant, i shpërngulur, i ardhur nga një vend tjetër), Fjalor fjalësh dhe shprehjesh të huaja nga Mikel Ndreca, Rilindja 1986 faqe 482

<sup>2</sup> Të dhënat nga Stefan L. Popoviq në shënimin e tij në librin Putovanje po Novoj Srbije, (Udhëtimi nëpër Serbi të Re) Beograd, 1950, faqe 345

rreth 700 lokalitete, prej të cilave rreth 640 plotësisht shqiptare e më shumicë shqiptare islame nga fundi i shekullit XVI dhe fillimi i shekullit XVII. Rreth 350.000 shqiptarë kryesisht myslimanë larguan nga trojet stërgjyshore ushtritë serbe, malazeze e bullgare. Burimet flasin për rreth 70.000 shqiptarë të therur, të vrarë e të pjekur në zjarrin e shtëpive në rreth 600 fshatra shqiptare të rrafshuara nga zjarri vetëm më 1877/78. Gjatë kësaj krahure kriminale, nuk u ndërmor asnjë hap nga Fuqitë e mëdha për të parandaluar gjenocidin me shumë tipare të kanibalizmit njerëzor të shfaqur veçanërisht nga serbët mbi shqiptarët e pambrojtur dhe shqiptarësinë e Sanxhakut të Nishit.<sup>3</sup> Këtë fat të hidhur , e kanë përjetuar edhe të parët e familjes sime Kurti – Muhaxhiri.

Nga i pari i kësaj familje, pra nga **Rexhep Kurti – Muhaxhiri** 1919 – 1994, kemi këta trashëgimtarë:

#### **IV. Rexhepi:**

1. Nexhmedin Muhaxhiri lindur më 31.12.1942 (babai im, martuar me Behije Çarkaxhiun, lindur më 18.01.1948);
2. Halil Muhaxhiri 1945 (axha);
3. Avni Muhaxhiri 1950 (axha);
4. Zyhra Muhaxhiri – Grubi 1953 (halla);
5. Sadete Muhaxhiri – Pozhegu 1955 (halla, binjake me hallën e mëposhtme);
6. Myrvete Muhaxhiri – Neziri 1955 (halla);
7. Ferdeze Muhaxhiri – Ferizi 1960 (halla).

Nga i pari i kësaj familje, nga **Nexhmedin R. Muhaxhiri** 1942, jemi këta trashëgimtarë:

#### **V. Nexhmedini:**

1. Dafina N. Muhaxhiri – Nela lindur më 27.10.1973 (shkruesja e kësaj gjenealogjie të trungut familjar, e martuar me Megzon Nela, lindur më 05.08.1965);
2. Visar N. Muhaxhiri, lindur më 10.09.1974 (vëllau);
3. Lirim N. Muhaxhiri, lindur më 01.09.1984 (vëllau).

Ndërsa unë, Dafina Nexhmedin Muhaxhiri – Nela, si fëmija i parë i kësaj familje, kam këtë trashëgimtare:

#### **VI. Dafina:**

1. Diandra Megzon Nela, lindur më 28.04.1995.

Pra, sipas këtyre të dhënave për trungun tim familjar, del se unë i takoj brezit të gjashtë familjar, ndërsa fëmija im (vajza Diandra) brezit të shtatë.

Vlen për të përmendur se të tërë trashëgimtarët e këtij trungu familjar, i takojnë fisit **Berishë**.

Shpresoj se në të ardhmen, në vazhdimësi dhe në formë më të plotë (duke dhënë shënime për trashëgimtarët e radhës së dytë, si nga hallat e gjyshit tim, ato të babait, të axhëve etj.) do ta plotësojë me ndihmën edhe të të tjerëve, këtë trung trashëgimie familjare.

---

<sup>3</sup> Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit 1877 – 1878 nga autori Dr. Sabit Uka.

Shkruar, më 01.04.2009 nga Dafina Muhaxhiri – Nela.